



Qendra e Shërbimeve Administrative

11303 Greendale
Sterling Heights, MI 48312
Phone: (586) 797-1000
Fax: (586) 797-1101
www.uticak12.org

Robert S. Monroe
Interim Superintendent

8 Janar, 2021

Të dashur Prindër/Kujdestarë:

Ndërsa fillojmë një vit të ri kalendarik, shpresoj që pushimet tuaja të kene qënë relaksuese dhe të këndshme. Kthimi i sigurt në mësimin ballë për ballë mbetet një qëllim i rëndësishëm në të gjithë komunitetin tonë shkollor. Gjatë javëve të ardhshme, studentët e Shkollave të Komunitetit të Utika që janë aktualisht të rregjistruar në opsionin e të mësuarit në distancë/të mësuarit në person do të kalojnë në udhëzime ballë për ballë me mësuesin e tyre në klasë.

Ndërsa përqendrohemi në një tranzicion të sigurt, këtu janë disa gjëra të rëndësishme për tu rishikuar:

- **Të gjithë studentët që janë të rregjistruar aktualisht në opsionin e mësimit në distancë/në person do të kthehen në klasë të Martën, me 19 Janar duke përdorur një model hibrid.** Drejtorët e shkollave së shpejti do të ndajnë informacione të mëtejshme në lidhje me mënyrën se si modeli hibrid dhe tranzicioni në të mësuarit në person do të ndikojë në shkollën dhe fëmijën tuaj.
- Siguria mbetet prioriteti jonë kryesor.
 - Studentët do të kthehen duke përdorur një qasje hibride. Kjo qasje lejon që më pak studentë të jenë në person në të njëjtën kohë për të promovuar distancën dhe për të zvogëluar ndërveprimin midis grupeve të ndryshme.
 - Personeli i shkollës sonë do të vazhdojë të ndjekë protokollet e rëndësishme të sigurisë që janë vendosur për të zvogëluar përhapjen e kësaj sëmundjeje. Kjo përfshin inkurajimin e larjes së shpeshtë të duarve, sigurimin e distancimit dhe veshjen e mbulesave të fytyrës.
 - Partneriteti juaj është thelbësor që ky të jetë një tranzicion i sigurt dhe i suksesshëm. Nëse studenti juaj po përjeton simptoma COVID-19, ju lutemi mbajini në shtëpi. Së bashku ne mund të zvogëlojmë përhapjen e këtij virusi në komunitetin tonë dhe të krijojmë një mjedis të sigurt të mësuarit në shkollë.
- Studentët e rregjistruar në Akademinë Virtuale të UCS do të vazhdojnë mësimet online deri në fund të vitit shkollor.
- Para pushimeve fundvitit, 500 familje zgjedhën të ndryshonin planet e të mësuarit për studentët për të përmbushur sa më mirë nevojat e familjeve të tyre.
 - Plan-Programi i ri 2020-2021 ka në dispozicion personelin dhe burimet për të akomoduar ndryshimet gjatë pjesës së mbetur të vitit shkollor.
 - Me finalizimin e orarit dhe stafit, ne nuk do të jemi në gjëndje të pranojmë kërkesa të mëtejshme.
- Qëllimi ynë është të vazhdojmë të ecim përpara nga modeli hibrid në udhëzime shtesë ballë për ballë sikur e lejon siguria.

Utica Community Schools Board of Education

Robert A. Ross, Ph.D., *President* Mary K. Thomas, Ph.D., *Vice President* Michele Templeton, *Treasurer* Denyeal Nesovski, *Secretary*
Kimberly Becker, *Trustee* Kelli Rankin, *Trustee* Steven R. Meyer, Ph.D., *Trustee*

- Ne do të rishikojme gjëndjen përsëri para dy pushimeve të planifikuara në kalendarin tonë shkollor - pushimet në mes të dimrit (15-19 Shkurt) dhe pushimet pranverore (5-9 Prill).
- Ne do të vazhdojmë të azhurnojmë panelin [our dashboard](#) në mënyrë që ju të keni informacionin më të fundit në lidhje me shkollën e fëmijës suaj dhe trendet e COVID-19 në komunitetin tonë.

Faleminderit për ndihmën për ta bërë mësimin ballë për ballë një realitet. Qëndrueshmëria dhe përkushtimi i palodhur i stafit dhe prindërve tanë vazhdojnë të sjellin ndryshimin. Së bashku ne do të plotësojmë nevojat akademike dhe emocionale të 26,000 studentëve në Shkollat e Komunitetit të Utika.

Sinqerisht,



Robert S. Monroe
Interim Superintendent